



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Rrjeti Kombëtar për Edukimin Ligjor të Publikut*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 3.3.2021, ora 13:00

**Drejton mbledhjen:**

**Vasilika Hysi – nënkryetare e Kuvendit**

**Rendi i ditës:**

1. Diskutim lidhur me rekomandimet e Bordit Këshillimor mbi metodat për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të strategjisë nga Komisioni Drejtues i Rrjetit dhe Ministria e Drejtësisë.
2. Të ndryshme.

**Marrin pjesë:**

Vasilika Hysi, Migena Leksoviku, Mirela Bogdani, Enkelejda Ollashi, Nadia Rusi.

**Mungojnë:**

Alma Hiçka.

## HAPET MBLEDHJA

**Vasilika Hysi** - Përshëndetje!

Uroj të jeni mirë vetë dhe familjarisht në këtë kohë pandemie!

Kjo është mbledhja e bordit këshillimor për këtë vit. Unë do të doja t'ju informoja, sikurse jeni vënë në dijeni edhe nga komunikimet *online* me Ministrinë e Drejtësisë, se në muajin nëntor të vitit 2020 u miratua plani i veprimit. Ndonëse me vonesë, për shkak të pandemisë dhe tërmetit, ne arritëm, së pari, të përmbushnim një nga objektivat e parashikuara në strategji, dhe, së dyti, institucionet, në përgjigje të detyrave që kishin, në kuadër të strategjisë dhe planit të veprimit, kanë raportuar te Ministria e Drejtësisë, e cila përgatiti raportin e parë. Këtë raport, pasi e ka diskutuar në Komitetin Drejtues Sektorial për Reformën në Drejtësi, ia përcolli edhe Kuvendit. Ne kemi pasur diskutime, e kemi analizuar raportin, u mblodh edhe komisioni drejtues i rrjetit, i cili e shqyrtoi raportin. Kopjen e raportit e keni.

Në varësi të problematikave që janë konstatuar ne menduam dhe thirrëm mbledhjen e bordit këshillimor për dy arsye: së pari, në bazë të strategjisë bordi këshillimor rekomandon, në aspektin cilësor të monitorimit, metodat për monitorimin dhe zbatimin e strategjisë nga komisioni drejtues i rrjetit dhe Ministria e Drejtësisë. Në këtë kuadër, do të vlerësonim shumë mendimet dhe sugjerimet se si ne si komision drejtues i rrjetit, por edhe Ministria e Drejtësisë, të punojmë për të pasur një rezultat më të mirë në zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit.

Strategjia e Edukimit Ligjor merr një rëndësi të veçantë edhe për shkak të situatës që ne po kalojmë, pasi të gjitha grupet shoqërore, ndaj të cilave është adresuar kjo strategji, kanë nevojë për më shumë informim në kushtet e pandemisë dhe masave kufizuese të marra nga qeveria. Prandaj, në këtë kuadër do të vlerësoja shumë mendimet, sugjerimet se si ne mund të bëjmë një monitorim më cilësor të strategjisë, por njëkohësisht rekomandimet për Ministrinë e Drejtësisë.

Arsyeja e dytë është se ne do të përgatisim mbledhjen e rrjetit, sipas strategjisë. Në fillim të vitit mblidhet rrjeti i Strategjisë së Edukimit Ligjor të publikut dhe do të mirëprisja edhe mendime dhe sugjerime lidhur me përgatitjen e mbledhjes së rrjetit.

Faleminderit!

Kush e do fjalën? Besoj se raportin e keni marrë, madje ishte voluminoz.

Po, Migena.

**Migena Leskoviku** – Faleminderit, zonja Hysi, për këtë mundësi!

Në vijim të takimeve, ku kemi marrë pjesë *online*, unë do të shprehja, duke u nisur edhe nga takimi i fundit, ku u prezantua nga përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë ose edhe përfaqësues të tjerë, që morën pjesë në kuadër të rrjetit plani i veprimit, raporti me elemente të caktuara, përfshirë kostimin dhe disa nga problematikat e evidentuara, unë do t'u referohem pikërisht disa çështjeve që u trajtuan në takimin e fundit *online*, i cili mendoj se meriton vëmendje, duke qenë se, siç e përmendët edhe ju, pati një vonesë në miratimin e planit të veprimit.

Megjithatë, ajo që do të doja të vija theksin në këtë drejtim është, sigurisht, duke konsideruar gjithë punën e madhe që është bërë nga të gjitha institucionet referuar atyre që u përmendën, nuk e di nëse për efekt të metodologjisë do të ishte e udhës të merrej në konsideratë çështja e trajnimit apo e udhëzimeve për personat përgjegjës në institucionet dhe ministritë e linjës në mënyrë që të plotësojnë siç duhet pjesë të caktuara në kuadër të detyrimeve që burojnë nga plani i veprimit.

E para, në aspektin metodologjik trajnimi, orientimi i vazhdueshëm dhe një udhëzues ndoshta më konkret për pjesë të mënyrës se si plotësohet dhe metodologjinë e plotësimit të detyrimeve që burojnë nga plani i veprimit do të ishte një çështje, e cila mendoj se duhet adresuar dhe duhet mbajtur parasys.

E dyta, një element tjetër që doja t'ju përmendja, meqenëse edhe në raportimin e fundit pati mangësi, duke iu referuar faktit që një pjesë e institucioneve ende nuk ishin... (*mungesë incizimi*)

**Vasilika Hysi** – Zonja Leskoviku, keni problem me audion.

**Migena Leskoviku** - ...nga Ministria e Arsimit, ndoshta duhet mbajtur parasys fakti që nga kjo pikëpamje, duke qenë se Ministria e Arsimit është një institucion qendror, i cili ka detyrimin kryesor, pra nuk i ka dytësore, por i ka kryesore, do të ishte e udhës edhe për efekt të indikatorëve dhe të detyrimeve që duhet të përmbushin institucionet duhet të mbahet parasys çështja e raportimit në kohë të paktën në fazën tjetër të vijimit të implementimit të strategjisë dhe planit të veprimit.

Ndoshta, nga kjo pikëpamje, në cilësinë e bordit ne mund të japim një këshillë edhe për pjesën e shtysës që mund t'u jepet këtyre institucioneve. Ne i kuptojmë vështirësitë, shpeshherë ka ndryshime titullarësh, impenjimet e përditshme të punës e kështu me radhë, por mendoj për sa u përket detyrimeve ato që janë detyrime konkrete nga pikëpamja metodologjike dhe nga

pikëpamja e korrektesës në raportim dhe në zbatim, duhet të jenë parësore dhe të marrin kohën e duhur.

Kjo ishte sa i takon kësaj pjese si konsideratë e përgjithshme.

Faleminderit!

**Vasilika Hysi** – Ju falënderoj për të tre sugjerimet, të cilat ishin të përmbledhur në dy nga ana juaj!

Kush e dëshiron fjalën?

**Olldashi** – Unë do të doja ta vazhdoja atë që po thoshte Migena. Mendoj se vërtet mund të hartohet *Guide line*, një udhërrëfyes, për institucionet që duhet të bëjnë raportim, duke iu dërguar atyre edhe formularin përkatës. Pra, të hartohet edhe një *Template* për mënyrën se si ato duhet të raportojnë në mënyrë që raportimet e tyre të jenë në vlefshme. Meqenëse disa institucione i kanë detyrat e ndryshme në lidhje me këtë strategji, sigurisht mund të kenë edhe formularë më vete.

Për shembull, në Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sportit detyrat janë më të ndryshme se sa i kanë profesionet e lira. Pra, për këto arsye formulari do t'i ndihmonte institucionet, por do të na ndihmonte edhe ne, si dhe të gjithë aktorët e tjerë për të pasur një *Feedback* për punën e kryer.

Kjo do të bënte që, pavarësisht ndryshimit të titullarëve apo të personave të kontaktit, në lidhje me këtë strategji në çdo rast kushdo që do t'i zëvendësonte do ta kishte më të thjeshtë për t'u orientuar dhe për t'u abdetuar në kohë me atë që duhet të bëjë.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zonja Olldashi!

Ideja juaj është e vlefshme për të pasur një siguri dhe një vazhdimësi të punës në nivelin e raportimit.

Po, zonja Rusi.

**Rusi** – Përshëndetje të gjithëve, duke ju uruar që të jeni mirë!

Në fakt, edhe unë do të doja që të vazhdoja në të njëjtën linjë edhe me dy koleget e bordit.

Doja të sillja në vëmendje që institucionet duhet të përdorin një format tashmë të zyrtarizuar, të përcjellë përmes Kryeministrisë, që është formati IPSIS, i cili thotë se, bazuar në vendimin për krijimin e sistemit IPSIS, të gjitha institucionet duhet të raportojnë përmes ndjekjes së metodologjisë së hartuar në këto institucione. Ky është një format i cili është shpërndarë nga zyrat e Kryeministrisë pranë të gjitha institucioneve. Kjo është një strategji që duhet të përdoret.

Për këtë arsye, mendoj se ndoshta do të ishte shumë mirë, edhe me idetë e sjella deri në këto momente, që të paktën sfera e trajnimeve të të gjithë personave, që janë përgjegjës për efektet

e raportimit, të mund të bazohet edhe në trajnimet në lidhje me metodologjinë dhe standardet që përdor IPSIS për sa i përket modulit të monitorimit, duke qenë se ky modul është një nga modulet që ka vetë sistemi në kuadër të monitorimit dhe raportimit të dokumenteve strategjike.

E them këtë për të mos shkuar drejt një ideje që çdo institucion mund të përdorë formatet e veta të raportimit për efekt edhe të raportimeve finale, duke qenë se tashmë kemi në një sistem dhe format të unifikuar për secilin prej tyre.

Në kuadër të këtij moduli, ndoshta do të duhet që, krahas këtyre trajnimeve të mund të hartohet edhe ky udhëzues, siç u përmend, sa i përket modulit të monitorimit bazuar në formatin IPSIS.

Nga ana tjetër, duke qenë se raportimi i parë nxori boshllëqet dhe mangësitë në kuadër të mungesës së raportimit për një pjesë të masave apo objektivave specifike nga institucione të caktuara, mendoj se, mbase edhe në kuadër të atyre parashikimeve që u bënë për efekt të monitorimit, të mund të shihej me kujdes edhe pjesa e rishikimit të planit të veprimit, me afatet që ne kemi përcaktuar, për të rakorduar edhe një herë të gjitha ato masa të parashikuara ndaj institucioneve.

E them këtë, se nga takimi i fundit u konstatua që një pjesë e institucioneve kanë pasur problematika për të raportuar edhe sa i përket sferës së kompetencës, edhe nëse janë ato masa, të cilat do të duhen t'i zbatojnë apo jo, në kuadër të kryerjes së detyrave funksionale, sipas kompetencave përkatëse. Kështu që, ndoshta do të ishte me vend që, në momentin që do të bëhej rishikimi i planit të veprimit, duke qenë se kemi rishikimet vjetore, të mundet të rakordohej me secilin prej institucioneve sidomos për ato masa, të cilat nuk janë raportuara, pra për ato masa që kanë dalë nga raportimi vjetor si të paraportuara ose në kuadër të atyre objektivave specifike, të cilat ishin të paraportuara.

Këto ishin dy nga elementet që do të doja të shtroja qoftë sa i përket përdorimit ose trajnimit të të gjitha institucioneve në lidhje me përdorimin e formatit IPSIS, edhe sa i përket rishikimit të planit të veprimit me efektin e një raporti më të plotë në muajt në vazhdim.

Faleminderit!

**Vasilika Hysi** – Ju faleminderit, zonja Rusi, edhe në vëmendje të formatit të IPSIS, i cili, në fakt, ashtu si në takimin që bëmë, u ngrit si një nga shqetësimet, pra kuptimi dhe zbatimi i tij.

E dyta, për rishikimin e planit të veprimit, ndërkohë ne si bord mund të japim disa mendime dhe sugjerime edhe për Ministrinë e Drejtësisë, pasi bordi këshillimor rekomandon, jo vetëm

komisionin drejtues, por edhe Ministrinë e Drejtësisë. Unë do të vlerësoja, nëse ju, të gjithë kolegët e nderuar, do të kishit ndonjë rekomandim edhe për rolin e komisionit drejtues, edhe të rrjetit, si mund të kontribuonin më shumë. Ajo që ne konstatojmë, është se një pjesë e institucioneve kanë bërë një punë shumë të madhe në fushën e edukimit ligjor, por nuk kanë raportuar, sikurse janë edhe klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë, që kanë bërë një punë të mirë, do të thosha, shumë të mirë dhe nuk kanë raportuar lidhur me ndihmën juridike falas ose problematikat që kanë konstatuar, me qëllim që ato të adresohet dhe në bazë të adresimit të tyre të gjenden zgjidhjet e mundshme, që mund të jenë institucionale, përditësime me ligjore, buxhetime më të mira, ngritje strukturash ose forcim kapaciteteve të tyre.

Në si Parlament kemi një rol shumë të rëndësishëm, se kemi mekanizmin e kontrollit parlamentar dhe buxhetimin. Kështu që, do ta vlerësoja shumë edhe për këtë aspekt çfarë mund t'i rekomandojmë Ministrisë së Drejtësisë dhe komisionit drejtues, për ta bërë më mirë këtë punë.

**Grua** - Po shikoja pak raportin vjetor që është dërguar nga rrjeti i SELP-it dhe do thosha që për raportim të parë, pak a shumë, aty jepen një seri të dhënash. Megjithatë, natyrisht që mund të ketë nevojë për një metodologji pak më specifike, kjo jo vetëm për të treguar, për ta raportuar dhe për ta shfaqur më mirë punën, por edhe për t'i ardhur në ndihmë të gjithë anëtarëve të rrjetit të edukimit ligjor të publikut, për t'i zhvilluar më mirë ato aktivitete që janë parashikuar, si dhe, natyrisht, për të gjetur mekanizmat për t'i raportuar.

Më vjen ndër mend, pasaporta e indikatorëve, është një proces që e ka ndërmarrë Ministria e Drejtësisë. Kam përshtypjen, ka qenë një organizatë joqeveritare, e cila në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë ka hartuar një set indikatorësh, që kanë bërë të mundur vlerësimin, qoftë të punës së ministrisë, qoftë të aktiviteteve që janë realizuar, ndoshta edhe të planit strategjik. Unë po përpiqesha ndërkohë, po kërkoja online, dikur e kam gjetur këtë pasaportën e indikatorëve, se m'u duk një koncept shumë novativ dhe shumë i vlefshëm për të matur progresin e një institucioni.

Në fakt, kjo mund të bëhet edhe në nivel organizate, jo domosdoshmërisht vetëm për institucionet e mëdha. Besoj që rrjeti ka nevojë për një set indikatorësh, minimumi të themi, dhe pastaj ky set indikatorësh mund të zhvillohet në nën indikatorë të tjerë, që mund të jenë sasiore dhe cilësore.

Unë nuk kam informacion për indikatorët që përmendi Nadia, për IPSIS, kërkova edhe në Google, me idenë që mund të kishte ndonjë publikim ose informacion në faqen e Këshillit të Ministrave, por për momentin nuk arrij dot që t'i aksesoj. Kështu që, nëse ju do të keni

informacion të detajuar, do t'ju lutem të na e vinit në dispozicion, të shikojmë cilët janë indikatorët e përgjithshëm që ka miratuar Këshilli i Ministrave. Besoj se duhet të jenë indikatorë për të gjithë institucionet dhe pastaj në vijim të setit të indikatorëve të prezantuar mund të shtojmë indikatorë të tjetër, që janë specifike për çështje që lidhen me fushën e drejtësisë dhe me edukimin ligjor të publikut.

Unë nuk e di, ndoshta mund të marrim një informacion edhe pak më të detajuar nga Ministria e Drejtësisë, nëse kanë qenë të kënaqur me këtë pasaportën e indikatorëve si proces, nëse e kanë realizuar dhe nëse do të na e sugjeronin si model, flas jo si model që ta marrim *mot à mot*, por si proces nga ku mund të marrim disa indikatorë, t'i zhvillojmë më tej dhe t'i riformatojmë sipas nevojave të Rrjetit të Edukimit Ligjor të Publikut.

Besoj që, në qoftë se do t'i kishim këto informacione dhe me indikatorët konkretë, do të ishte më e thjeshtë pastaj edhe të jetësonim ato që thanë Migena, Enkelejda apo Nadia, domethënë të hartonim një formular, të hartonim një *guideline* apo edhe të trajnonim personat përgjegjës.

Pa e pasur këtë set indikatorësh, kam përshtypjen se do të jetë pak e vështirë t'i realizojmë këto procese. Kështu që, në qoftë se biem dakord për këtë grup indikatorësh, për mënyrën se si do të raportohet, pra për një metodologji monitorimi dhe raportimi, do të jetë shumë më e thjeshtë pastaj të hartojmë udhëzues, të dizenojmë një formular dhe më pas t'i trajnojmë personat që të kenë mundësi ta plotësojnë atë dhe, kur t'i kemi këto, informacioni që do të marrim do të jetë shumë më i thjeshtë edhe për t'u përpunuar nga sekretariati teknik në trajtën e raportimeve periodike ose të raportimeve vjetore.

**Vasilika Hysi** – Shumë faleminderit, zonja Bogdani, për dy sugjerimet e vlefshme!

Në fakt, ne do t'ia kërkojmë Këshillit të Ministrave që të kemi formatin IXIS. Metodologjia e raportimit ishte një nga vështirësitë që u konstatua dhe u theksua edhe nga Ministria e Drejtësisë, edhe nga përfaqësuesja e Kryeministrit.

Lidhur me pasaportën e indikatorëve, ju keni të drejtë, të gjitha projektligjet që po vijnë në parlament aktualisht, pjesa më e madhe e tyre ka një rregull: janë të pajisur me pasaportën e indikatorëve, e cila na shërben neve për të bërë vlerësimin postlegjislativ nëse ligji i ka përmbushur objektivat, kostot, ndikimin në mjedis, në jetën social-ekonomike e me radhë dhe ka një format standard. Do të përpiqemi nëpërmjet shërbimeve të Kuvendit që ta sigurojmë edhe këtë.

Në rastin konkret unë e di që strategjia nuk ka pasaportë indikatorësh, Iva.

**Grua**– E ka.

*(Ndërhyrje)*

**Vasilika Hysi** – E ka?

**Grua** – E ka dhe, madje, e ka shumë të mirë.

**Vasilika Hysi** – Atëherë, ju e keni, e kam fjalën.

**Grua** – Po, po.

**Vasilika Hysi** – Jo, e kam fjalën, është *online*.

**Grua** – Po, po.

**Vasilika Hysi** – Shumë mirë!

Lidhur me...

**Grua** – Strategjia e edukimit ligjor të publikut është bashkë me pasaportën e indikatorëve dhe ka ndjekur pothuajse të njëjtin format, në fakt, që ka edhe IPSIS për sa i përket pasaportës së indikatorëve, duke qenë se tashmë kuadri strategjik ose të gjitha dokumentet strategjike do të duhet që të bashkëshoqërohen me pasaportën e indikatorëve, por sipas metodologjisë së sistemit IPSIS. Sepse vetëm Mirela, nëse mund edhe ta përmend, IPSIS në vetvete nuk është një pasaportë indikatorësh, por është sistemi i menaxhimit të planifikimit të të dhënave, i unifikuar tashmë për të gjithë kuadrin strategjik, i cili përbëhet nga disa module dhe njëri prej moduleve është pikërisht moduli i monitorimit dhe raportimit.

Metodologjia që do të duhet të përdoret duhet të ndiqet sipas moduleve të hartuara nga vetë Këshilli i Ministrave në këtë rast për sa i përket sistemit.

Të paktën me sa kam unë informacion, në momentin që u hartua dhe u vendos në jetë sistemi, pothuajse strukturat në ministri u trajnuan për sa i përket mënyrës së përdorimit të sistemit. Megjithatë, në këtë rast trajnimi do të duhet të jetë i detajuar për efekt të njërit prej moduleve, që, siç e përmenda, është monitorimi dhe raportimi. Ndërkohë, në kontekstin e Strategjisë së Edukimit Ligjor të Publikut duhet të shihen pikërisht ato indikatorë, të cilët janë vendosur në pasaportën e indikatorëve. Unë kam përshtypjen se janë 39 indikatorë, nga sa e kam konsultuar pasaportën e indikatorëve. Kështu që, do të duhet të shikohen edhe në këndvështrimin e raportimit, bazuar mbi indikatorët e Strategjisë së Edukimit Ligjor të Publikut. Pasaporta do të duhet të jetë si aneks i fundit i strategjisë. Kam përshtypjen që është edhe te materiali i publikuar.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit!

Zonja **Rusi**, shtojca e parë, tabela e treguesve të monitorimit, është më se e qartë për të katërt objektivat dhe periudhat. Në fakt, nga verifikimet, gjëja e parë dhe kryesore për këtë pikë



ka qenë numri i akteve ligjore dhe nënligjore të identifikuar për përmirësim në kuadër të edukimit ligjor, buxhetimi, numri i punonjësve të ngarkuar. Ndoshta në këtë kuadër i rikthehemi atij problemi që ju e prekët të gjithë, që pavarësisht se kush është personi i ngarkuar në institucion, duke pasur një metodologji të përcaktuar mund të bëhet edhe vlerësimi i burimit njerëzor, por edhe e performancës së tij.

Njëkohësisht, për objektivin e dytë ka tregues të tjerë dhe pasaporta e treguesve është. Mua më pëlqeu, më duket e tha zonja Bogdani, për të bërë një vlerësim të zbatimit në vitin e parë të shtojcës të treguesve. Për pasaportën ndoshta mund të jetë pak herët, sepse është viti i parë dhe plani i veprimit në nëntor është miratuar, por një organizatë e shoqërisë civile, vetë universiteti apo fakultetet e drejtësisë mund të bëjnë një vlerësim se sa janë mbajtur në konsideratë indikatorët dhe zbatimi i pasaportës. Pra, mund të kemi një raport hije, krahas raportit që ka përgatitur Ministria e Drejtësisë. Vlerësimi i jashtëm do të ishte po ashtu efektiv sikurse është edhe vlerësimi që i bën Kuvendi apo vetë Ministria e Drejtësisë punës së bërë.

Ka goxha tregues të detajuar, të matshëm, të cilët mund të analizohen. Për shembull, mua më ka tërhequr vëmendjen fakti që kur kemi thënë vlerat e synuara, ne kemi pas parashikuar tri iniciativa të përbashkëta midis anëtarëve të rrjetit. Kemi tri iniciativa midis shoqërisë civile, klinikave ligjore që administrojnë shërbimin ligjor falas për vitin 2019-2020, ndërkohë që për vitin 2021 përsëri ka objektiva ose synime të mirëpërcaktuara.

Ka ndonjë gjë tjetër për të shtuar?

Po, Migena.

**Migena Leskoviku** – Faleminderit!

Gjithmonë duke iu referuar këtyre diskutimeve që po bëjmë dhe meqë u kërkua si një opinion, por edhe nga takimi i fundit online dhe raporti i përgatitur, unë mendoj se ka dalë çështja e komunikimit më të mirë edhe në nivel të brendshëm, sidomos kur vjen puna të kostifikimi për aktivitete të caktuara. Mendoj që edhe kjo duhet pasur parasysh kur flasim për efekt të ndërgjegjësimit të strukturave në institucione të caktuara, që kanë detyrimin të raportojnë. Nga ana tjetër, edhe rakordimi i informacionit të marrë nga pikat e kontaktit, veçanërisht kur këtu bëhet fjalë për çështje që lidhen me financimin dhe kostifikimin që bëjnë drejtoritë e financave përpara momentit të raportimit pranë Ministrisë së Drejtësisë, në mënyrë që informacioni që del të jetë i plotë, me cilësi, që është një element shumë i rëndësishëm, sepse nuk mjafton thjesht raportimi

nga pikëpamja formale, sipas formatit IPSIS nga të gjitha institucionet që përfshihen dhe kanë detyrime që burojnë nga klani i veprimit.

Elementi i tjetër është çështja e bashkëpunimit jo thjesht me institucionet përgjegjëse, por edhe me organizata të shoqërisë civile, sidomos ato që ofrojnë ose bëjnë që bëjnë punë të vazhdueshme për efekt të zbatimit të kësaj strategjie që kanë edhe një impakt më konkret, por, në të njëjtën kohë, u janë përgjigjur me efikasitet, në kohë dhe me cilësi detyrimeve që burojnë për këtë pjesë të raportimit. Domethënë, ajo pjesë që u takon organizatave të shoqërisë civile dhe mbështetja që ato japin në kuadër të planit të veprimit dhe të strategjisë të shikohet më mirë e rakorduar, sigurisht duke qenë se edhe kontributi i tyre është i matshëm, ashtu siç është i matshëm edhe i institucioneve. Kështu që, nga kjo pikëpamje, duhet parë edhe këto këndvështrim të bashkëpunimit, të rakordimit dhe të koordinimit ndërmjet të gjitha këtyre strukturave, institucioneve dhe organizatave të shoqërisë civile.

E fundit, duke qenë se në raport edhe herën e kaluar u përmend, në fakt, çështja e një lloji gëpi, një lloj boshllëku ndërmjet pasaportës së indikatorëve dhe planit të veprimit pasi, siç doli edhe në takimin e kaluar, ka institucione ose subjekte që nuk janë përgjegjëse në plan veprim, por që rezultojnë përgjegjëse në pasaportën e indikatorëve, atëherë nga pikëpamja metodologjike mendoj se duhet parë çështja e plotësimit të këtij gëpi, pra i këtij boshllëku.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zonja Leskoviku!

Të gjitha mendimet dhe sugjerimet tuaja ishin shumë të dobishme. Unë kam një pyetje dhe do të doja një mendim nga ana juaj.

Në bazë të tabelës së treguesve të monitorimit të SELP-it lidhur me një objektiv të caktuar, objektivi 2/3 ku thuhet: “Konkretizimi i bashkëpunimit ndër-institucional për realizimin e iniciativave të përbashkëta për zbatimin e edukimit ligjor të publikut sugjerohet që Komisioni i Rrjetit të marrë vendime përiniciativatë përbashkëta midis anëtarëve të Rrjetit në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor”. Njëkohësisht, tregues janë edhe memorandumet që kanë ushtruar institucionet e arsimit të lartë me Drejtorinë e Ndihmës Juridike të garantuar nga shteti. Për këtë të dytën ka tregues dhe raporti përmban informacion, ndërkohë që ne si komision drejtues nuk kemi marrë një vendim konkret lidhur me nismat një duhen ndërmarrë. Nuk kemi marrë, pasi plani i veprimit është miratuar në muajin nëntor, por tashmë që kemi një raport dhe kemi konstatuar progresin e bërë në disa fusha, por edhe mangësitë në një fushë tjetër, do të vlerësoja shumë të kishit ndonjë opinion, ndonjë mendim nga ana juaj, një sugjerim konkret se çfarë vendimi mund të merrte Komisioni

Drejtues i Rrjetit për ta hedhur në tryezën e takimit të Rrjetit, që do të zhvillohet së shpejti, lidhur me iniciativat e përbashkëta. Ndoshta një veprimtari mund të jetë edhe me Kuvendin, një aktivitet tjetër mund të jetë ndërmjet universiteteve dhe shoqërisë civile, por ndoshta mund të jenë edhe aktivitete konkrete që mund të bëjnë studiot ligjore falas, për shembull, me punonjësit që punojnë në fasoneri që nuk dinë se si të kërkojnë të drejtat e tyre në kuadër të humbjes së vendit të punës për shkak të kufizimit nga pandemia ose përfitimeve nga paketat mbështetëse të nxitjes së punësimit e të tjerë, që në këtë periudhë nuk janë të pakta nga qeveria dhe shumica e njerëzve. Të paktën nga raportet e studimeve të shoqërisë civile që unë kam në dorë dhe kam lexuar, rezulton që nuk i dinë. Ndërkohë, fondet janë, sepse janë fonde të miratuara nga buxheti i shtetit ose janë grante të miratuara në Kuvendin e Shqipërisë të dedikuara për kategoritë e njerëzve që kanë humbur punën për shkak të pandemisë. Për shembull, një prej tyre më erdhi në mend në këtë moment, prandaj do të vlerësoja ndonjë sugjerim para se të shkojmë në mbledhjen e Rrjetit për tri nisma të përbashkëta midis anëtarëve të rrjetit dhe tri nisma të përbashkëta ndërmjet shoqërisë civile dhe ndihmës juridike, institucionit që është në varësi të Ministrisë së Drejtësisë. Ndoshta mund t'i paraqisni edhe me shkrim nëse nuk mundeni sot, për të parë më mirë atë pjesë të raportit ku ka vakum dhe sidomos në shtojcën e parë. Edhe pasaporta e indikatorëve ka tregues, por janë pak më afatgjatë.

**Vasilika Hysi** – Po, zonja **Leskoviku**.

**Migena Leskoviku** – Në vijim të asaj që ju përmendët, zonja Hysi, meqenëse herën e kaluar edhe sugjerimet i dhamë si trupë, kolegjisht, ndoshta nëse sërish do të diskutonim mes nesh dhe t'ju jepnim disa sugjerime në të njëjtën mënyrë, siç e dhamë edhe herën e parë, në mënyrë që të rrahim dhe të diskutojmë mendimet mes nesh, që të dalin një set sugjerimesh më të plota dhe rekomandimesh që pastaj t'i keni dhe t'i mbani parasysh. Ky është një propozim imi. Ndoshta edhe me shkrim, duke vendosur ju një afat ose duke pasur parasysh se cili mund të jetë një *deadline* para mbledhjes së radhës që ju keni me rrjetin.

**Vasilika Hysi** – Shumë faleminderit!

Është e mirëpritur, rëndësi ka që të kemi disa sugjerime. Ne mendojmë që mbledhjen e rrjetit duhet ta thërrasim sa më shpejt. Meqenëse këtu jam bashkë me këshilltaret dhe me sekretariatit e strategjisë, mendojmë që të paktën maksimumi për një javë ne duhet të mbledhim rrjetin.

Po, zonja Voltani.

**Voltani** – Patjetër që mund të diskutojmë dhe mund të japim diçka me shkrim që mund të jetë më e mirë organizuar dhe më e mirë menduar, por ndërkohë që flisnim mendoj që nisma ligjore, pra ndihma ligjore falas, duhet të ketë një qasje disi praktike.

Në *facebook* kam parë informacion që janë ngritur pika konkrete, ku qytetarët mund të shkojnë dhe të marrin informacion. Ajo që mund të ishte e vlefshme, meqenëse ju përmendët punëtorët që punojnë në fasoneri, pra njerëz që përballen në përditshmërinë e tyre me këto lloj praktikash ose problemesh, do të ishte mirë që të kishte skuadra lëvizëse, në mënyrë që të vendosnin komunikimin direkt me këto grupe në nevojë ose persona që kanë interes, por që nuk dinë se cila është faqja e internetit ku mund të marrin informacion apo të pyesin. Kjo mund të bëhet me 2 nënaktivitete, e para, mund të krijohen skuadra lëvizëse, që mund të aksesojnë direkt grupet në nevojë dhe këtu ndoshta do të ketë nevojë për një informacion, se ku gjenden këto fasoneri, cilët janë grupet më vunerabël, terrenet që mund të aksesohen e kështu me radhë, sepse mund të jetë pak më i vështirë identifikimi.

Nga ana tjetër, mund të krijohet një *link* ose portal i dedikuar vetëm për ndihmën ligjore në kushtet e pandemisë. Nëse kjo mund të promovohet nëpërmjet rrjeteve sociale, do të ishte e thjeshtë edhe për njerëzit që të shkruajnë pyetjet dhe të merrnin përgjigjet *online*, ose mund kemi edhe një komunikim direkt me personat që i dedikohen këtij shërbimi, pra të flasim në telefon. Mund të krijohet edhe një linjë *hotline* me numër me 0800, që personat ta aksesojnë pa pagesë. Kjo do ta bënte shumë më të shpejtë dhe shumë më praktike edhe komunikimin me publikun, edhe ndihmën, edhe zgjidhjen e problemeve që ata mund të kenë. Kjo është gjëja e parë. Pastaj gjërat e tjera mund t'i diskutojmë rrugës, por duke u vendosur në pozitë të një njeriu që mund të ketë nevojë për ndihmë, mendoj që kjo gjë do të shërbente më shumë, pra mund të jetë më efektive për momentin.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit!

Kjo është një ide shumë e mirë, pasi po të klikosh një pyetje në *google* do të dalin shumë faqe me përgjigje të thjeshta dhe ne gjejmë përgjigje për shumë nga pyetjet tona, pavarësisht se nuk janë në shqip, janë në anglisht, por ka informacion.

Kjo tregon se modelet nuk mungojnë dhe mund të bëhet ...

**Bogdani** – Më falni, se ju ndërpreva fjalën!

Diçka tjetër që mund ta shtoj është se, përveç ekspertëve, në çështjet e tatimeve, taksave, çështjeve ekonomike apo ligjore, unë do të sugjeroja të ketë edhe një psikolog ose sociolog, sepse

është e nevojshme që njerëzit, të cilët përballen me këto problematika, të kenë edhe një suport emocional.

Të gjithë po kalojmë një periudhë të vështirë dhe shpesh suporti emocional mund të zgjidhë treçerekun e problemit ose mënyrën se si ti e percepton problemin.

Grupet mund të jenë të kordinuara. Për shembull, një për ekonominë, një për suportin jashtë shërbimeve ligjore dhe një tjetër, që mund të suportoje emocionalisht personat që kanë nevojë, qoftë për menaxhimin e stresit, qoftë për menaxhimin e problemeve apo për çfarëdoq nevojë që ata mund të kenë. Besoj se shërbimi merret i kompletuar, pra jo vetëm për çështjet ligjore.

**Vasilika Hysi** – Unë jo pa qëllim e hapa këtë çështje, edhe për shkak të telefonatave dhe mesazheve që marrim, por në kuadër të ngarkesës që kanë institucionet, të cilat botojnë, dhe faqet e tyre kanë jashtëzakonisht shumë informacion, shikoj një aset shumë të madh.

Universitetet, duke pasur pedagogët mentor dhe duke përdorur kapacitetet e shumta me studentët e masterave në fushat përkatëse, te konkurrenca, dhe sidomos marrëdhëniet e punës në të drejtat që lidhen me financën, me bankën, mendoj se kjo punë mund të punohet shumë mirë nga shtëpia. Ndoshta mund t'ia sugjerojmë edhe rrjetit, që universitetet, sipas profilit të tyre, bashkë me pedagogët, të bëjnë projekte të tilla. Pa dyshim që informacioni, i dhënë nga një profesori i fushës, është shumë më i dobishëm se një përgjigje që mund të japin përfaqësuesit e institucioneve, që nuk e njohin sa dhe si duhet punën. Mund të jetë edhe një gërshetim i punonjësve të praktikës me ata të teorisë, duke përdorur studentët, në mënyrë që të ketë më pak kosto dhe në të njëjtën kohë të punojnë më shumë burime njerëzore. Kjo është një ide.

Nëse nuk keni gjë tjetër, dhe sot është e mërkurë, a do të mundemi deri të premte ose të shtunën, të kemi disa sugjerime dhe ne të bëjmë mbledhjen me rrjetin?

Po, Migena.

**Migena Leskoviku** – Besoj se po.

Mes nesh, sigurisht, në shpejtësinë e kohës, edhe për efekt të limiteve, mendoj se ne mund ta ndajmë me njëra-tjetrën, qoftë edhe *online* ose përmes komunikimit elektronik, meqenëse jemi në periudhë pandemie. Ndoshta mund të jetë gati deri të shtunën, nëse do të jetë mirë edhe për ju.

Nuk e di nëse koleget kanë mendim tjetër, por unë do të thosha të kishim 2-3 ditë kohë.

**Vasilika Hysi** – Ju të gjitha jeni të nderuara, të respektuara dhe shumë korrekte. Kuvendi nuk ka qenë korrekt me ju. Unë sapo mësova nga Iva që Kuvendi nuk ka përmbushur disa detyrime ndaj jush, çështje, për të cilën mezi pres të mbyll mbledhjen dhe të merrem, sepse sapo e mora

vesh. Unë kam besim se brenda afateve që ne ju vendosim, gjithmonë me nxitim, ju do t'i përmbushni. Besoj se javën që vjen do të kemi mbledhjen e rjetit.

Nëse nuk keni gjë tjetër, do të doja t'ju falënderoja shumë për kohën dhe mundësitë për të komunikuar!

Gjithmonë është kënaqësi të komunikojmë me profesionistë, ekspertë të palodhur, dhe gjithmonë gratë janë në krye të këtyre punëve!

Ju uroj shëndet dhe gjithë të mirat!

Do të jemi në kontakt.

**MBYLLET MBLEDHJA**